



Vilfrida Bushati është pjesë e stafit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) që në muajin gusht 2010 në pozicionin e Drejtores së Drejtorisë së Hetimit Administrativ. Ka mbaruar studimet bachelor dhe master shkencor në të Drejtë Publike pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës si dhe master shkencor në Administrim Publik në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Tiranës & Universiteti i Nebraskes (MPA7). Gjithashtu mban diplome të nivelit të dytë për matematikë pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkoder.

Eksperiencën në administratën publike ka filluar që nga viti 2006 si specialiste pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, Ministria e Financave dhe më tej në vitin 2010 në pozicionin e Përgjegjës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Ministria e Financave.

Në vitin 2016 është certifikuar nga Këshilli Evropës në kuadër të programit HELP (Human Rights Education for Legal Professionals) për “Kursin për Çështjet e Antidiskriminimit” si dhe ka ndjekur po nga ky program kurset “Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Azil Kerkuesit”, “Biznesi dhe të Drejtat e Njeriut” si dhe kurse të tjera që kjo platformë ofron.

Nga shtatori 2022 –mars 2023 ka ndjekur dhe është certifikuar nga Programi i Avancuar i Trajnimit Ndërkombëtar (ITP 6) me rëndësi strategjike për zhvillimin social dhe ekonomik të vendeve pjesëmarrëse me temë: “Parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës me bazë gjinore: Forcimi i agjentëve të ndryshimit”, ofruar nga Agjencia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar

(SIDA) zbatuar nga Autoriteti Policor Suedez në bashkëpunim me organizatën suedeze të shoqërisë civile, Fondacioni “Kvinna till Kvinna”.

Nga viti 2022 e në vijim ushtron aktivitetin si trajnuese pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASP), në fushën e mosdiskriminimit lidhur me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Përafrimin me Direktivat e BE”.

Eshtë certifikuar për mbarimin me sukses të “Trajnimit për trajneret, teknikat mbi trajnimet on line dhe personalisht” mbështetur nga Kolegji i Evropës në emër të projektit ASPA dhe GIZ “Mbështetje për negociatat e anëtarësimit në Kapitullin Ekonomik të acquis (SANECA).

Ka qenë për pesë vite 2015-2019 përfaqesuese e KMD-së në grupet e punës së EQUINET (Rrjeti European i Institucioneve të Barazisë me qendër në Bruksel) me fokus rritjen e kapaciteteve të punonjesve të Trupave të Barazisë të Europës që nga fundi i vitit 2014, vit kur KMD u bë pjesë e këtij institucioni European shumë të rëndësishem. Në këtë kuadër ka qenë pjesë e grupit " Equality Law", i cili çdo vit ka kryer studime specifike mbi fushën e mosdiskriminimit, ku ka dhënë kontributin si përfaqesuese e KMD në keto studime të botuara, pjesë e Cluster -Funksionet Quasi-Gjyqësore te Institucioneve te Barazise si dhe Evaluation Lab - projekt dy vjeçar që synonte të sigurojë një platformë për anëtarët ekspertë të organeve të barazisë të interesuara dhe me përvojë në “Proceset dhe treguesit për matjen e ndikimit të organeve të barazisë” si dhe e një sërë seminaresh, konferencash dhe trajnimesh te organizuara nga ky rrjet mbi fushen e mosdiskriminimit.

Në kuadër te Equinet është angazhuar në grupin e punës që ka përgatitur ndërhyrjet e EQUINET si palë e tretë pranë GJEDNJ për çështjet me objekt diskriminimi.

Ka marrë pjesë aktive në grupet e punës me ekspertë të huaj dhe vendas të cilët kanë mbështetur KMD-në nder vite si dhe në kuader të projektit të BE-Keshilli i Europes " Rritja e efektivitetit të Sistemit Shqiptar Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Mosdiskriminimit" i cili ka ndihmuar KMD-në të përpilojë të gjithë infrastrukturen duke filluar nga Strategjia 2018-2021, Rregullore e Brendshme, ndryshime ligjore si dhe një sërë trajnimesh që synojnë rritjen e kapaciteteve të stafit të KMD-së në standartet e një trupe barazie Europiane.

Ka përfaqësuar KMD-në në një sërë aktivitetesh: Grupe pune, seminare , konferenca brenda dhe jashtë vendit, raportime periodike në Komitete dhe Nënkomitete në Bruksel në kuader te MSA-

së. Gjithashtu nga viti 2010 e ne vazhdim ka marrë pjesë si trajnuese, perfaqesuese e KMD-së, në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Komisioneri në bashkepunim me Organizata të ndryshme që ushtrojnë aktivitet ne fushen e te drejtave të njeriut.